



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:003683

Datë: 18.03.2024

Numri i dokumentit: 05467170

C.nr.59/2022

GJYKATA THEMELORE PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, në çështjen kontestimore të paditëses S. L. nga fshati P., K. e D., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson D. C., avokat në D., kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria Komunale për Arsim, me seli në Deçan, të cilën e përfaqëson Dukagjin Povataj, Avokat Publik Komunal, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë dhe kompensimin e pagës mbi bazën e përqindjes së inflacionit, me vlerë të kontestit prej 831,60 euro, jashtë seance, me datë 18.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses S. L. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria për Arsim, që paditëses në emër të shpenzimeve të udhëtimit në punë për periudhën nga data 31.12.2019 e deri më datën 30.10.2022, për 594 ditë pune, t'i paguaj shumën prej 831,60 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 11.01.2022 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Deçanit, Drejtoria për Arsim që paditëses, në emër të shpenzimeve të procedurës, t'ia paguaj shumën prej 124,00 euro, në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

III. KONSTATOHET e tërhequr padia C.nr.59/2022, e datës 11.01.2021 e paditëses S. L., sa i përket kërkesës për kompensimin e pagës mbi bazën e inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësja në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 11.01.2022, përmes të autorizuarit të saj, si dhe me parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë të datës 27.09.2023, ka kërkuar që të detyrohet e paditura t'ia kompensoj paditëses shpenzimet e udhëtimit në punë dhe atë për 594 ditë pune shumën prej 831,00 euro, si dhe t'i kompensoj paditëses pagën mbi bazën e përqindjes

së inflacionit në vend në shumë prej 870,96 euro, me kamatë ligjore prej 8%, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës. Përfaqësuesi me autorizim i paditëses me parashtrësën e datës 01.03.2024, ka precizuar edhe njëherë kërkesëpadinë duke theksuar se mbete pranë kërkesës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit në punë, ndërsa lidhur me kërkesën për kompensimin e pagës mbi bazën e përqindjes së inflacionit ka deklaruar se tërhiqet nga kjo kërkesë.

E paditura, përmes avokatit publik komunal, me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ku ka theksuar se paditësja nuk i është drejtuar shkollës ku punon e as Drejtorisë së Arsimit për realizimin e kërkesës lëndore, pra ka ushtruar padi në gjykatë pa shterur procedurat administrative të punëdhënësi, tutje ka theksuar se paditësja të drejtën e kërkon nga data 31.12.2019 deri me 30.10.2022, mirëpo kontrata nuk ka efekt retroaktiv që do të thotë se nga data 31.12.2019 e deri në momentin e nxjerrjes së kontratës së re të vitit 2021, paditëses nuk i takon përqindja e inflacionit dhe as shpenzimet e udhëtimit, po ashtu ka theksuar se ekziston dhe kontrata e arsimit e vitit 2017, por për njohjen e të drejtës në bazë të saj kemi parashkrim sepse neni 87 i Ligjit të Punës, përcakton se kërkesat e tilla parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, andaj ka propozuar që padia e paditëses të aprovohet pjesërisht dhe atë vetëm nga koha e nxjerrjes së kontratës së re kolektive të vitit 2021.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditëses është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Gjykata fillimisht vlerëson se nuk ishte kontestuese mes palëve se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në Sh.F.M.U. “H. e D.”, në fshatin G., K. e D., fakt i cili vërtetohet edhe nga kontrata e punës e lëshuar nga Komuna e Deçanit, Drejtoria për Arsim, me numër të protokollit dhe datë 10.10.2012, po ashtu nuk ishte kontestuese se vendbanimi i paditëses është në fshatin P., K. e D., fakt i cili vërtetohet edhe nga letërnjoftimi për paditësen i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Ndërsa nga vërtetimi i lëshuar nga “K. T.”, në D. me numër ../.... i datës 05.01.2022, vërtetohet se paditësja është udhëtare e rregullt e kompanisë së tyre dhe udhëton çdo ditë pune në relacionin P.-G., po ashtu nga i njëjti vërtetohet se çmimi i biletës së udhëtimit në një relacion është 1,00 euro.

Nga vërtetimi i lëshuar nga shkolla “H. e D.”, në fshatin G. me numër të protokollit ../.. i datës 05.12.2022 vërtetohet se paditësja është punëtoare e shkollës në fjalë dhe nga i njëjti vërtetohen ditët e prezencës në punë për paditësen, ashtu që vërtetohet se paditësja për periudhën nga data 31.12.2019 e deri me datë 30.10.2022, ka gjithsej 594 ditë të prezencës në punë.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 paragrafi 5, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, datë 18.04.2017, si dhe të datës 21.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, i u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”, erdhi në përfundim se paditëses i takon kompensimi i kërkuar për shpenzimet e udhëtimit, ngase me provat e

lartcekura, është vërtetuar lartësia e kërkesëpadisë së paditëses, andaj duke llogaritur 594 ditë udhëtimi për periudhën nga data 31.12.2019 e deri më datën 30.10.2022, për 70% të biletës së udhëtimit, vlerën 1,40 euro në dy drejtimet, gjykata ia njohu shumën prej 831,60 euro paditëses, sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditëses, t’ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë të aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se paditësja nuk ka shterur mjetet juridike gjykata vlerësoj se nuk qëndron ky pretendim, për faktin se gjykata nuk është e lidhur me mjetet administrative brenda institucionit përkatës kur vendos lidhur me kërkesën. Rrjedhimisht paditësja, si e punësuar në arsim, nuk ka qenë e detyruar që të bëjë kërkesë të veçantë për kompensim për shkak të shpenzimeve të udhëtimit në punë, pasi të njëjtën punëdhënësi do të duhej ta përmbushte në momentin që janë plotësuar kushtet për kompensim, prandaj meqë një detyrim i tillë nuk është përmbushur, ka lindur e drejta për të kërkuar kompensimin përmes rrugëve gjyqësore, siç ka vepruar në rastin konkret paditësja.

Ndërsa, sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 31.12.2019 deri me datë 30.10.2022 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 11.01.2022, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 paragrafi 2 të LPK duke pas parasysh suksesin në procedurë të paditëses, me ç’rast paditëses iu pranuan shpenzimet si vijon për përpilimin e padisë shuma prej 104,00 euro, si dhe për taksë gjyqësore shuma prej 20,00 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 124,00 euro.

Duke pas parasysh se pala paditëse me parashtrësën e datës 01.03.2024 ka tërhequr padinë sa i përket kërkesës për kompensim mbi bazën e inflacionit, parashtrësë e cila është paraqitur pasi

që pala e paditur ka paraqitur përgjigje në padi, andaj gjykata konform nenit 261 paragrafi 2 të LPK, me aktvendimin C.nr.59/2022 të datës 05.03.2024 ka kërkuar pëlqimin e paditëses se a pajtohet ose jo lidhur me tërheqjen e padisë sa i përket kërkesës lidhur me kompensimin e pagës mbi bazën e inflacionit, duke e njoftuar që nëse e njëjta brenda afatit prej 7 (shtatë) ditësh nuk deklarohet lidhur me tërheqjen, do të konsiderohet se ka dhënë pëlqimin. E paditura pavarësisht se me datë 06.03.2024 ka pranuar aktvendimin në fjalë nuk është deklaruar lidhur me tërheqjen, andaj gjykata konsideroj se njëjta ka dhënë pëlqimin dhe vendosi sikurse në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit konform nenit 261 paragrafi 3 të LPK dhe konstatohet të tërhequr padinë e paditëses sa i përket kërkesës për kompensimin e pagës mbi bazën përqindjes së inflacionit në vend.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEGA NË DEÇAN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.59/22 me 18.03.2024

Gj y q t a r i

Bajram Cacaj

KËSHILA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi në pikën I dhe II të dispozitivit është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.

Lidhur me pikën III të dispozitivit të aktgjykimit nuk është e lejuar ankesa, konform nenit 261.4 të LPK.